



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 71/2020

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga anëtarët: Rrustem Thaçi kryesues, Adnan Konushevci dhe Burim Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik “Yenilikçi Turk Hareket Partisi” (YTHP), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit me Nr.933-2020 të datës 21.10.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos regjistrimit të subjektit politik “Yenilikçi Turk Hareket Partisi” (YTHP) në regjistrin e partive politike, në seancën e panelit të mbajtur me 26.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. **PRANOHET** si i bazuar apeli Anr.71/2020 i datës 22.10.2020 i parashtruar nga subjekti politik “Yenilikçi Turk Hareket Partisi” (YTHP), me seli në Prizren.
- II. **ANULOHET** vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me Nr.933-2020 të datës 21.10.2020, dhe **çështja i kthehet në rishqyrtim KQZ-së.**

A r s y e t i m

PZAP-i me datën 22.10.2019 ka pranuar një apel nga subjekti politik “Yenilikçi Turk Hareket Partisi” (YTHP) paraqitur nga Ertan Simitçi, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. Nr.933-2020 të datës 21.10.2020, me të cilën i është refuzuar kërkesa për regjistrim e subjektit politik në regjistrin e partive politike me numër protokolli 807 të datës 25.09.2020. Parashtruesi i apelit thekson se vendimi i KQZ-së për mos regjistrimi i subjektit politik “Yenilikçi Turk Hareket Partisi “ me akronim (YTHP) është i kundërligjshëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore dhe kushtetuese si dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, pasi që subjekti politik në fjale duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislativonit në fuqi si dhe Rregullores Nr. 01/2013 të KQZ-së për Regjistrimin të Partive Politike ka plotësuar dhe ka zbatuar të gjitha procedurat për regjistrim. I njëjti thekson se me datën 05.10.2020 ëeb faqen e KQZ-së, është publikuar njoftimi nga KQZ për shqyrtim publik për regjistrimin si parti politike, si dhe ZRPPC-ja ka dhënë rekomandimin KQZ-së për regjistrimin e partisë

politike në fjalë, me çka sipas parashtruesit të apelit i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për regjistrim. I njëjti thekson se me datën 21.10.2020 KQZ ka marrë vendim për refuzimin e rekomandimit të ZRPPC-së pa asnjë arsyetim-sqarim apo bazë ligjore. Parashtruesi i apelit i ka propozuar panelit që apeli të miratohet si i bazuar dhe të anulohet si i kundërligjshëm vendimi i KQZ-së dhe çështja ti kthehet të njëjtit organ për rishqyrtim.

Kërkesës për regjistrim i është bashkangjitur: Shqyrtimi publik në ëeb faqen e KQZ-së (linkun) për Iniciativën Politike “Yenilikçi Turk Hareket Partisi, vendimin e KQZ-së datës 21.10.2020 për Iniciativën Politike “Yenilikçi Turk Hareket Partisi” dhe për të drejtën e ankesës në PZAP (brenda 24 orëve)

KQZ-së në përgjigjen e saj me nr. protokollin 946 të datës 23.10.2020, thekson se nga ana e ZRPPC-së është përgatitur materiali për regjistrim dhe me të njëjtin e ka njoftuar KQZ-në duke i rekomanduar që kërkesën për regjistrimit e iniciativës politike Yenilikçi Turk Hareket Partisi ta aprovon, pasi që procedura e aplikimit ka qenë konform Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores Nr. 01/2013. Më tutje në përgjigjen e KQZ-së theksohet se në procesin e votimit në KQZ në mbledhjen e mbajtur me 21.10.2020 rekomandimi i ZRPPC-së dështoi të marrë 2/3 e votave të gjithë anëtarëve të KQZ-së sipas nenit 63.4 të LZP-së

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 21.10.2020 me numër protokollin 933/2020 të KQZ-së dhe përgjigjes në apel të ZRPPC - KQZ gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se ZRPPC-së me datën 12.10.2020 ka rekomanduar KQZ-në se subjekti Politike “Yenilikçi Turk Hareket Partisi” me akronim (YTHP), i ka plotësuar kushtet ligjore për tu regjistruar në regjistrin e Partive Politike.

KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.10.2020, nuk e ka miratuar rekomandimin e ZRPPC-së, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vendimin e atakuar të KQZ-së, nuk mund ta pranoi si të drejtë dhe të ligjshme meqenëse se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 12 paragrafi 3 të LZP-së, që i referohen regjistrimit të subjekteve politike dhe të Rregullës Nr. 01/2013 të KQZ-së, për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike ku me nenin 5 të kësaj Rregulle në mënyrë shprehimore janë paraparë arsyet për refuzimin e regjistrimit të një subjekti politik.

Në rastin konkret në vendimin e goditur nuk është dhënë asnjë arsye ligjore mbi bazën e se cilës është refuzuar regjistrimi i subjektit politik në fjalë.

Nga arsyet e cekura Paneli vendosi që ta miratoj apelin (si ne propozim) dhe vendimin e ankimuar të KQZ-së, ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rivendosje KQZ-së.

Me rastin e rivendosjes KQZ-ja sërish do të vlerësoj bazueshmërinë e kërkesës për regjistrim të Iniciativës Politike “Yenilikçi Turk Hareket Partisi”, duke ju referuar nenit 5 të Rregullës Nr. 01/2013 të KQZ-së dhe pas vlerësimit të gjitha provave të marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Rrjedhimisht me rastin e rivendosjes KQZ-ja duhet të ketë parasysh vlerësimin e plotësimit të kushteve ligjore për regjistrimin e subjektit politik në fjalë dhe po ashtu të verifikoj faktin se nga statuti dhe programi i këtij subjekti nuk rezulton ndonjë qëllim me kundërshtimin e rendit juridik. Andaj vendimi duhet bazuar në kushtet e përcaktuara ligjore duke i vlerësuar ato në kuptim të plotësimit të tyre ose jo, siç ka vepruar në këtë rast KQZ-ja, pa dhënë arsye ligjore për refuzim të kërkesës.

Në pajtim me nenin 115.1 lidhur me nenin 118.1 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 71/2020 më datën 26. 10.2020



Kryesuesi i Panelit,
Brustem Thaçi

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi
nuk lejohet ankesa.*

